



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:199327

Datë: 15.01.2025

Numri i dokumentit: 06712559

P.nr.217/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit F.S. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së dhe të pandehurit E.A. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1180/24 e datës 19.08.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar e publik të mbajtur me datë 13.01.2025, në të cilin ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Albana Parduzi, i dëmtuari SH.I., i pandehuri F.S., i pandehuri E.A., mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të pandehurit F.S. avokat Naser Azemi dhe mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të pandehurit E.A. avokat Nexhat Beqiri, më datën 13.01.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.01.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I PANDEHURI: F.S. nga i ati S..., e ëma A..., e gjinisë Z..., data e lindjes... në Vushtri, ku edhe tani jeton në rr. ..., me numër personal të identifikimit ..., nuk ka të kryer asnjë klasë të shkollës, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar.

II. I PANDEHURI: E.A. nga i ati H..., e ëma A..., e gjinisë N..., data e lindjes... në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon si elektrikist herë pas here, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

JANË FAJTORE

I. I PANDEHURI I PARË F.S.:

SEPSE: Me datë 14.07.2024, rreth orës 00:30, në rrugën “Bedri Pejani”, Vushtrri, saktësisht në lokalin “Llamarinë punues Shpëtimi”, i pandehuri me dashje dhe qëllim të përvetësimit të kundërligjshme të pasurisë për vete merr pasurinë e të dëmtuarit SH.I., në atë mënyrë që të pandehurin Faton deri tek lokali e dërgon i pandehuri Egzon me veturën e tipit “Mercedes 250”, pastaj del nga vetura shkon në lokal dhe e hap derën e lokalit, ashtu që mbi tavolinë i dëmtuari i kishte lënë paratë për t’u terur, pasi që së bashku me kuletë i kishin rënë në ujë, ashtu që i pandehuri i merr paratë në shumën shtatëqind (700) euro dhe del nga lokali, takohet me të pandehurin Egzon i cili ishte duke e pritur, me te cilin veprim të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material në vlerën 700.00 euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRKsë.

II. I PANDEHURI I DYTË E.A.:

SEPSE: Me datë 14.07.2024, rreth orës 00:30, në rrugën “Bedri Pejani”, Vushtrri, i pandehuri E.A. me dashje ndihmon të pandehurin F.S. në kryerjen e veprës penale Vjedhja e rëndë, ashtu që me veturën e tipit “Mercedes 250”, e dërgon deri afër vendit të kryerjes së veprës penale dhe e pret derisa e përfundon, ku takohet te sheshi “Hasan Prishtina”, lokali “Tiriqi” dhe e dërgon në shtëpi.

- Me këtë ka kryer veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 31, 33, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72, 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449, 452 dhe 460 të KPPK-së, i

G J Y K O N

I. Të pandehurit: F.S. për veprën penale të përshkruar si në pikën I të dispozitivit i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjete (18) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjete (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej nëntëqind (900) euro i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne periudhën verifikuese në kohëzgjatje dy (2) viteve.

II. Të pandehurit: E.A. për veprën penale të përshkruar si në pikën II të dispozitivit i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëmijë (1000) euro i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri E.A. refuzon të paguaj këtë dënim me gjobë ose nuk mundet, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

Të pandehurit F.S. koha e kaluar në mbajtje nga data 14.07.2024 ora 08:00 e deri me datën 15.07.2024 në ora 18:00 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Të pandehurit E.A. koha e kaluar në mbajtje nga data 14.07.2024 ora 11:00 e deri me datën 15.07.2024 në ora 18:00 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Pala e dëmtuar SH.I. ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

DETYROHET të pandehurit secili veç e veç që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1180/24 e datës 19.08.2024, kundër të pandehurit F.S. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së dhe të pandehurit E.A. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 e lidhur me nenin 33 të KPRKsë.

Deklarimi i të pandehurve lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 13.01.2025, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, të njëjtëve i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri F.S. ka deklaruar se e pranon fajësinë, i vjen keq për atë që ka ndodhur, është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale dhe i premtton gjykatës që nuk do të përsëris më vepra penale të njëjta apo të ngjashme, ndërsa i pandehuri E.A. ka deklaruar se e pranon fajësinë, i vjen keq për atë që ka ndodhur, është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale, e po ashtu i kërkon falje të dëmtuarit për atë që ka ndodhur.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që i njëjti është bërë vullnetarisht dhe pa presion, pas konsultimit me mbrojtësit e tyre, ka mbështetje në faktet që i përmban aktakuza andaj gjykatës i

propozon që të aprovoj pranimin e fajësisë, ndërsa lidhur me rrethanat ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë rrethanave të cilat janë paraqitur në aktakuzë, përkatësisht në pikën II të aktakuzës.

Pala e dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se heq dorë nga kërkesa pasurore juridike me kushtin që do të heqin dorë nga kryerja e veprave të tilla penale, ndërsa lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit ka deklaruar se i propozon gjykatës që të pandehurve të i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Avokati mbrojtës i të pandehurit të pare lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që ky pranim i fajësisë është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë ashtu që i propozon gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, ndërsa lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit i ka propozuar gjykatës që të mbrojturit të tij të i shqiptoj një dënim të kushtëzuar duke pasur parasysh se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, e gjithashtu është i paarsimuar, nuk ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për pasojat e kryerjes së kësaj vepre penale.

Avokati mbrojtës i të pandehurit të dyte lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që ky pranim i fajësisë është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë ashtu që i propozon gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, ndërsa lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit i ka propozuar gjykatës që të mbrojturit të tij të i caktoj një dënim më të butë me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurve, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të njëjtit, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: procesverbali i marrjes së deklaratës në procedurë paraprake për të pandehurin F.S., i datës 15.07.2024, procesverbali i marrjes së deklaratës në procedurë paraprake për të pandehurin E.A., i datës 15.07.2024, raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2024BD-634, i datës 14.07.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin SH.I., i datës 14.07.2024, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht, i datës 14.07.2024, procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarin F.S., i datës 14.07.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin E.A., i datës 14.07.2024 dhe raporti i njësisë së forenzikës me numër të dosjes 25-24, i datës 14.07.2024, ku gjendet një skice nga vendi i ngjarjes, fotoalbumi në shtojcë i përbërë nga 10 fotografi si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose ndonjë gabim faktik.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehurit F.S. ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe i pandehuri E.A. ka kryer veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në nenin 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Vjedhja e rëndë e kryen *“Kushdo që kryen vjedhje duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet”.*

Me nenin 33 të KPRK-së është përcaktuar definicioni i ndihmës dhe elemente e saj ku parashihet se *“Kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet më dënim më të butë sesa kryesi i veprës.”* dhe *“Ndihma për të kryer një veprë penale përfshin, por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.”*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin F.S. të e shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së dhe të pandehurin E.A. të e shpall fajtor për kryerjen e veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtave përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat janë edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurve, bazuar në nenin 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethanë posaçërisht lehtësuese lidhur me të pandehurin e parë ka marr pranimin e fajësisë nga ana e tij, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale dhe gjendjen ekonomike të tij në bazë të cilës të pandehurit i kushtëzoi dënimin me gjobë ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, shkallen e lartë të dashjes, mosbashkëpunimin e tij me gjykatën, përkatësisht i njëjti nuk i është bindur thirrjeve dhe urdhrave të gjykatës në raport me seancat e caktuara, kjo pasi që gjykata ndaj tij me datë 27.12.2024 ka lëshuar letë rreshtim dhe faktin se i njëjti ka qenë edhe me parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë e cila është vërtetuar nga evidencat penale dhe atë me aktgjykimin P.nr.307/2020 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, i

plotfuqishëm me datë 07.06.2022, ndërsa lidhur me të pandehurin e dyte gjykata si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale dhe faktin se i njëjti më herët nuk ka ra ndesh me ligjin, respektivisht nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit apo te dëmtimit të vlerës se mbrojtur, shkallen e lartë të dashjes dhe faktin se i njëjti nuk ka qenë bashkëpunues, respektivisht nuk i është bindur thirrjeve të gjykatës në raport me seancat e caktuara, kjo pasi që gjykata ndaj tij me datë 27.12.2024 ka lëshuar urdhër arrest.

Në pajtim me nenin 79 të KPRK-së të pandehurit F.S. koha e kaluar në mbajtje nga data 14.07.2024 ora 08:00 e deri me datën 15.07.2024 në ora 18:00 dhe të pandehurit E.A. koha e kaluar në mbajtje nga data 14.07.2024 ora 11:00 e deri me datën 15.07.2024 ora 18:00 i llogaritet në dënimin e përcaktuar.

Sipas bindjes së gjykatës, për të pandehurin F.S. dënimi me burg në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjete (18) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjete (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënimi me gjobë në shumën prej nëntëqind (900) euro i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe për të pandehurin E.A. dënimi me burg në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe dënimi me gjobë në shumën prej njëmijë (1000) euro i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurve do të arrihet qëllimi i dënimin nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtëve nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me palën e dëmtuar gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 të KPPK-së ku është përcaktuar se “*Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe atë ta realizojnë në kontest civil. Kur propozimi tërhiqet, i njëjti propozim nuk mund të paraqitet përsëri, përveç nëse me këtë Kod është paraparë ndryshe.*”, kjo pasi që pala e dëmtuar në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 13.01.2025 ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Numri i lëndës: 2024:199327
Datë: 15.01.2025
Numri i dokumentit: 06712559

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal P.nr.217/2024, datë
15.01.2025

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.